REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 341, Datë 06.11.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, RINOVIMIN, NJOHJEN DHE TRANSFERIMIN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; neneve 15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3500 prot., datë 05.11.2026, përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026 *"Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, rinovimin, njohjen dhe transferimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*

Konstatoi se:

- Ligji nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", ka përcaktuar kuadrin e ri ligjor për organizimin, funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, duke sjellë ndryshime në regjimin e licencimit, kategoritë e veprimtarive që i nënshtrohen këtij regjimi, si dhe kushtet dhe kërkesat për ushtrimin e tyre. Në veçanti, dispozitat e neneve 40–43 të këtij ligji përcaktojnë veprimtaritë që i nënshtrohen licencimit, përjashtimet nga detyrimi për pajisjen me licencë, kohëzgjatjen e licencave dhe procedurat për shqyrtimin e aplikimeve. Këto ndryshime bëjnë të nevojshëm përshtatjen e akteve rregullatore të ERE-s, me qëllim përcaktimin e procedurave, kritereve dhe dokumentacionit për pajisjen me licencë dhe ushtrimin e veprimtarive përkatëse, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri.
- *Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor të mëparshëm dhe ka shërbyer si akti kryesor rregullator për administrimin e procedurave të licencimit nga ERE.
- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026, është bërë i nevojshëm rishikimi i kësaj rregulloreje, me qëllim harmonizimin e dispozitave të saj me kërkesat e reja ligjore, përfshirjen e veprimtarive të reja që i nënshtrohen licencimit, si dhe qartësimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesin aplikuesit. Rishikimi synon gjithashtu përcaktimin më të qartë të kritereve të vlerësimit dhe të përgjegjësive të subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari të licencuara në sektorin e energjisë elektrike.
- Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026 dhe rishikimit të kuadrit rregullator të licencimit, ERE ka filluar më parë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores së posaçme që përcakton rregullat dhe procedurat për heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike. Për këtë arsye, gjatë hartimit të projekt-rregullores objekt shqyrtimi është mbajtur në konsideratë ndarja e procedurave të licencimit dhe administrimit të licencave nga

procedurat për heqjen e tyre, të cilat do të trajtohen në akte rregullatore të veçanta. Kjo ndarje synon të shmangë mbivendosjen e dispozitave, të përcaktojë qartë objektin dhe fushën e zbatimit të secilit akt dhe të mundësojë trajtimin e posaçëm të procedurave për heqjen e licencave, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2026.

- Me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, është ngritur Grupi i Punës për hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore që lidhen me licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive të licencuara, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026. Në zbatim të këtij urdhri, Grupi i Punës ka shqyrtuar dispozitat e kuadrit ligjor të ri dhe rregulloren ekzistuese, duke evidentuar nevojën për përshtatjen e procedurave të licencimit me kategoritë e veprimtarive dhe kërkesat e përcaktuara në ligj. Në përfundim të kësaj faze të punës është përgatitur projekt-rregullorja "*Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, rinovimin, njohjen dhe transferimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike*", së bashku me anekset përkatëse, për t'iu nënshtruar shqyrtimit dhe konsultimit me palët e interesuara.
- Projekt-rregullorja përcakton kushtet dhe kriteret për pajisjen me licencë, dokumentacionin e përgjithshëm juridik, financiar, organizativ dhe profesional, si dhe dokumentacionin specifik teknik që kërkohet për secilën veprimtari. Në këtë kuadër, projektakti parashikon kërkesa të veçanta për prodhimin e energjisë elektrike, operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes, përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes, furnizimin, tregtimin, operimin e tregut, depozitimin e energjisë elektrike dhe agregimin. Përcaktimi i dokumentacionit sipas natyrës së veprimtarisë synon t'i mundësojë ERE-s vlerësimin e kapaciteteve teknike, financiare dhe organizative të aplikuesve, duke garantuar njëkohësisht qartësi dhe trajtim të njëtrajtshëm të kërkesave për licencim.
- Ky dokument parashikon gjithashtu dispozita të posaçme për trajtimin e veprimtarive të ushtruara nga klientët aktivë dhe komunitetet energjetike, duke përcaktuar se detyrimi për licencim lidhet me natyrën e veprimtarisë që ushtrohet dhe me përjashtimet e parashikuara në nenin 40 të ligjit nr. 59/2026. Në këtë kuadër, projektakti synon të qartësojë kërkesat që zbatohen për këto kategori subjektesh, duke shmangur vendosjen e detyrimeve të pajustifikuara për veprimtaritë që nuk i nënshtrohen licencimit. Njëkohësisht, projekt-rregullorja përfshin kërkesa të posaçme për licencimin e veprimtarisë së depozitimit të energjisë elektrike dhe agregimit, duke marrë në konsideratë karakteristikat teknike dhe organizative të këtyre veprimtarive, si dhe detyrimet për sigurinë e operimit dhe pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike.
- Një pjesë e rëndësishme e projekt-rregullores i kushtohet përcaktimit të procedurave administrative për paraqitjen, verifikimin dhe shqyrtimin e aplikimeve për licencim. Projekt-akti parashikon verifikimin paraprak të dokumentacionit, rastet e fillimit ose mosfillimit të procedurës, mënyrën e trajtimit të mangësive të konstatuara, publikimin e njoftimeve për aplikimet, si dhe administrimin dhe shqyrtimin e vërejtjeve dhe kundërshtimeve të paraqitura nga institucionet publike dhe palët e interesuara. Gjithashtu, përcaktohen rregullat për kërkimin e informacionit plotësues, respektimin e afateve procedurale dhe përgatitjen e relacionit përfundimtar për vendimmarrje nga bordi i ERE-s. Këto përcaktime synojnë të sigurojnë transparencë, objektivitet dhe trajtim të barabartë të aplikuesve gjatë gjithë procesit të licencimit.
- Projekt-rregullorja trajton procedurat për modifikimin, rinovimin, transferimin dhe njohjen e licencave, duke përcaktuar rastet kur kërkohet ndërhyrja e ERE-s, dokumentacionin

përkatës dhe kriteret që duhet të vlerësohen gjatë shqyrtimit. Për modifikimin e licencave parashikohet trajtimi i ndryshimeve të kapaciteteve, karakteristikave teknike dhe kushteve të ushtrimit të veprimtarisë, përfshirë rastet e integrimit të impianteve të depozitimit me impiantet ekzistuese të prodhimit. Për rinovimin e licencave parashikohet vlerësimi i përmbushjes së detyrimeve gjatë periudhës së mëparshme të licencimit, ndërsa për transferimin dhe njohjen e licencave përcaktohen kërkesat për verifikimin e kushteve ligjore dhe të aftësisë së subjekteve për të vijuar ose për të filluar ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

- Në lidhje me veprimtarinë e depozitimit të energjisë elektrike, projekt-rregullorja parashikon dokumentacion të posaçëm teknik, financiar dhe të sigurisë, duke përfshirë karakteristikat e impianteve, kapacitetin e depozitimit, kushtet e lidhjes me rrjetin dhe mënyrën e operimit. Gjithashtu, projekt-akti trajton rastet e depozitimit të integruar me prodhimin dhe parashikon marrjen në konsideratë të dokumentacionit të administruar më parë nga ERE për operatorët që përfitojnë nga regjimi kalimtar i nenit 51 të ligjit nr. 59/2026. Këto përcaktime synojnë të mundësojnë shqyrtimin e kërkesave për licencim duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të impianteve të depozitimit dhe fazën e zhvillimit ose operimit të tyre.
- Ky dokument shoqërohet me 13 anekse, të cilat janë konceptuar si pjesë përbërëse e saj dhe përcaktojnë formularët e aplikimit, dokumentacionin e përgjithshëm dhe specifik sipas veprimtarive, si dhe kërkesat për procedurat e modifikimit, rinovimit, transferimit dhe njohjes së licencave. Anekset përfshijnë gjithashtu dokumentacionin për veprimtaritë e reja të parashikuara nga ligji nr. 59/2026, informacionin mbi pagesat e aplikimit dhe modelin e regjistrit publik të licencave. Standardizimi i dokumentacionit synon të lehtësojë paraqitjen e aplikimeve, të përmirësojë procesin e verifikimit nga strukturat përgjegjëse të ERE-s dhe të shmangë kërkesat e përsëritura për dokumente që institucioni i disponon dhe që mbeten të vlefshme.
- Përpara miratimit përfundimtar, projekt-rregullorja dhe anekset e saj duhet t'i nënshtrohen procesit të konsultimit me palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e zbatueshme për miratimin e akteve rregullatore të ERE-s. Publikimi i projekt-aktit synon të mundësojë njohjen e subjekteve të licencuara, aplikuesve, operatorëve të sistemit, pjesëmarrësve të tregut dhe institucioneve të tjera të interesuara me ndryshimet e propozuara, si dhe paraqitjen e komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve.
- Pas përfundimit të konsultimit, Grupi i Punës do të shqyrtojë dhe vlerësojë komentet e administruara, do të reflektojë propozimet që vlerësohen të bazuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor, si dhe do të përgatisë projekt-aktin dhe relacionin përfundimtar për shqyrtim dhe vendimmarrje nga bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, rinovimin, njohjen dhe transferimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike"* dhe anekseve bashkëlidhur saj.

2. Projekt-rregullorja do t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës, dhe përgatitjen e materialeve për vijimin e procedurës së miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 341, Datë 06.11.2026

Projekt– RREGULLORE

PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, RINOVIMIN, NJOHJEN DHE TRANSFERIMIN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo Rregullore përcakton kategoritë e veprimtarive që i nënshtrohen licencimit në sektorin e energjisë elektrike, kushtet dhe kriteret për pajisjen me licencë, dokumentacionin që duhet të paraqesin aplikuesit, si dhe procedurat dhe afatet për shqyrtimin dhe vendimmarrjen nga ERE.

2. Rregullorja përcakton gjithashtu rregullat dhe procedurat për modifikimin, rinovimin, transferimin, njohjen dhe heqjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Qëllimi dhe parimet

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave, kritereve dhe procedurave që zbatohen nga ERE për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke garantuar transparencën, objektivitetin dhe trajtimin e barabartë të aplikuesve, si dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për ushtrimin e veprimtarive të licencuara.

Neni 3
Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*".

Neni 4
Fusha e zbatimit dhe veprimtaritë e licencuara

1. ERE shqyrton kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe njohjen e licencave për veprimtaritë e prodhimit, operimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes,

përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, operimit të tregut, depozitimit të energjisë elektrike, agregimit dhe operimit të pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike, në përputhje me ligjin nr. 59/2026.

2. Kjo rregullore zbatohet gjithashtu për klientët aktivë dhe komunitetet energjetike, për veprimtaritë që kërkojnë licencim dhe që nuk përfshihen në rastet e përjashtimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke respektuar procedurat e posaçme të regjistrimit të përcaktuara në aktet përkatëse.

3. Për çdo veprimtari të licencueshme kërkohet licencë e veçantë kur nuk përcaktohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Licencimi i veprimtarisë së operimit të pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike të aksesueshme nga publiku

1. Veprimtaria e operimit të pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike i nënshtrohet licencimit nga ERE, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 45, pika 8, dhe neni 46, pika 2, e këtij ligji.

2. Për pajisjen me licencë për këtë veprimtari zbatohen kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë, karakteristikat teknike të pikave të rikarikimit, sigurinë e operimit dhe përmbushjen e kërkesave për lidhjen dhe përdorimin e rrjetit të energjisë elektrike.

Neni 6

Licencimi i veprimtarive të ushtruara nga klientët aktivë

1. Klientët aktivë, që ushtrojnë veprimtari të prodhimit, depozitimit, shitjes së energjisë elektrike të vetëprodhuar ose që marrin pjesë në agregim, i nënshtrohen regjimit të licencimit sipas përcaktimeve të neneve 40 dhe 96 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. Detyrimi për licencim përcaktohet në varësi të natyrës së veprimtarisë së ushtruar, kapacitetit të instaluar dhe përjashtimeve të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr. 59/2026.

3. Kur klienti aktiv ushtron veprimtari që i nënshtrohen licencimit dhe nuk përfshihen në përjashtimet ligjore, ai paraqet kërkesë për pajisjen me licencën përkatëse, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Në shqyrtimin e kërkesave për licencim të klientëve aktivë, ERE zbaton kërkesa teknike, administrative dhe financiare proporcionale me natyrën, kapacitetin dhe karakteristikat e veprimtarisë, duke shmangur vendosjen e detyrimeve të pajustifikuara ose diskriminuese.

5. Klientët aktivë që ushtrojnë veprimtari nëpërmjet një agreguesi nuk konsiderohen, subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e agregimit. Kur klienti aktiv ushtron vetë veprimtarinë e agregimit, zbatohen kërkesat për licencimin e kësaj veprimtarie, sipas nenit 40 të ligjit nr. 59/2026.

Neni 7

Licencimi i veprimtarive të komuniteteve energjetike të qytetarëve

1. Komunitetet energjetike të qytetarëve mund të ushtrojnë veprimtari të prodhimit, konsumit, depozitimit, ndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike, si dhe të ofrojnë shërbime agregimi, në përputhje me nenin 99 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. Statusi i komunitetit energjetik të qytetarëve nuk përbën, në vetvete, objekt të një licence të veçantë nga ERE. Komunitetet energjetike pajisen me licencë për veprimtaritë që ushtrojnë, kur këto veprimtari i nënshtrohen licencimit sipas nenit 40 të ligjit nr. 59/2026.

3. Për veprimtaritë e prodhimit dhe depozitimit të energjisë elektrike, komunitetet energjetike të qytetarëve përfitojnë nga përjashtimet e parashikuara në nenin 40 të ligjit nr. 59/2026, nëse plotësojnë kushtet dhe kufijtë e përcaktuar në këtë nen.

4. Për veprimtaritë e furnizimit, agregimit ose veprimtari të tjera që i nënshtrohen licencimit, komunitetet energjetike të qytetarëve pajisen me licencën përkatëse, përveç rasteve kur ligji parashikon shprehimisht përjashtim nga ky detyrim.

5. Ndarja e energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve të komunitetit energjetik të qytetarëve trajtohet sipas dispozitave të posaçme të ligjit nr. 59/2026 dhe akteve rregullatore të miratuara nga ERE. Ushtrimi i kësaj veprimtarie nuk kërkon licencë furnizimi, kur plotësohen kushtet ligjore për përjashtimin nga licencimi.

6. Komunitetet energjetike të qytetarëve, që aplikojnë për licencim, paraqesin dokumentacionin e kërkuar për veprimtarinë përkatëse, si dhe dokumentacionin që vërteton statusin juridik të komunitetit, mënyrën e organizimit, përfaqësimin ligjor dhe të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca.

7. Kur komuniteti energjetik i qytetarëve ushtron veprimtarinë e operimit të një sistemi shpërndarjeje, licencimi dhe kushtet përkatëse përcaktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 59/2026 dhe aktet e tjera ligjore e rregullatore që rregullojnë këtë veprimtari.

Neni 8

Përjashtimet nga licencimi

1. Në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", nuk kërkohet pajisja me licencë nga ERE për rastet e mëposhtme:

   a) Për funksionimin e një linje direkte, për të cilën nuk kërkohet licencë për veprimtarinë e transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike.

b) Për prodhimin e energjisë elektrike nga klientët aktivë që nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tyre gjeneruese.
c) Për prodhimin e energjisë elektrike nga prodhuesit, përfshirë klientët aktivë të lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.
d) Për operimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar të fuqisë nominale deri në 1 MW.
e) Për veprimtarinë e rishitjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimit të pikës 110 të nenit 3 të ligjit nr. 59/2026, për të cilën nuk kërkohet licencë furnizimi.
f) Për veprimtarinë e ndarjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimit të pikës 73 të nenit 3 të ligjit nr. 59/2026, për të cilën nuk kërkohet licencë furnizimi.

2. Përjashtimet e përcaktuara në shkronjat "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni zbatohen vetëm pasi ERE të ketë përcaktuar kushtet maksimale të çmimeve përkatëse dhe subjektet të kenë kryer njoftimin pranë ERE-s, në përputhje me pikën 10 të nenit 40 të ligjit nr. 59/2026.

3. Subjektet që përjashtohen nga detyrimi për licencim, sipas përcaktimeve të këtij neni, janë të detyruara të respektojnë rregullat e tregut, kodet e rrjetit dhe kërkesat e tjera ligjore e rregullatore të zbatueshme për veprimtarinë që ushtrojnë.

4. Përjashtimi nga detyrimi për licencim nuk i përjashton subjektet nga mbikëqyrja rregullatore e ERE-s. Në përputhje me nenin 40, pikat 4 dhe 11, të ligjit nr. 59/2026, ERE ushtron kompetencat e saj për monitorimin, kërkimin e informacionit, vendosjen e detyrimeve të raportimit, kryerjen e inspektimeve dhe hetimeve, si dhe marrjen e masave administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Kohëzgjatja e licencës

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës përcaktohet me vendim të Bordit të ERE-s, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë, jetëgjatësinë teknike dhe ekonomike të aseteve, afatin e autorizimeve ose marrëveshjeve përkatëse, kapacitetet teknike dhe financiare të aplikuesit, si dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 41, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 59/2026, kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) vjet për veprimtaritë e mëposhtme:

a) Prodhimin e energjisë elektrike;
b) Operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
c) Operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
d) Operimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike;
e) Agregimin.

3. Për veprimtaritë e furnizimit, operimit të tregut të energjisë elektrike, operimit të pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike dhe sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës përcaktohet me vendim të Bordit të ERE-s, për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë, kapacitetet teknike, financiare dhe organizative të aplikuesit, si dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

4. Për klientët aktivë dhe komunitetet energjetike të qytetarëve që ushtrojnë veprimtari të cilat i nënshtrohen licencimit, kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës përcaktohet sipas afatit të parashikuar për veprimtarinë përkatëse, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 10
E drejta për aplikim dhe përfaqësimi

1. Të drejtën për të paraqitur kërkesë për pajisjen me licencë pranë ERE-s e ka çdo person juridik, vendas ose i huaj, i cili përmbush kërkesat ligjore për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse në sektorin e energjisë elektrike, si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit ose nga një person i autorizuar prej tij, nëpërmjet një dokumenti që vërteton të drejtën e përfaqësimit dhe përcakton shtrirjen e autorizimit.

2. Personat juridikë të huaj kanë të drejtë të aplikojnë për pajisjen me licencë pranë ERE-s, në përputhje me legjislacionin shqiptar, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe dispozitat e kësaj rregulloreje. Këta aplikues duhet të vërtetojnë ekzistencën e tyre juridike, regjistrimin e vlefshëm në shtetin e origjinës, regjistrimin në një nga format e parashikuara nga legjislacioni i Republikës për sa i përket regjistrit tregtar, të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, si dhe përmbushjen e kërkesave teknike, financiare dhe organizative të zbatueshme për licencimin.

3. Kur legjislacioni në fuqi ose marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme parashikojnë njohjen e regjistrimit, autorizimit ose licencës së lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër, ERE zbaton procedurat përkatëse të njohjes, pa kërkuar regjistrim ose licencim të dyfishtë, për aq sa kjo lejohet nga dispozitat ligjore përkatëse.

4. Dokumentacioni i lëshuar nga autoritetet e huaja paraqitet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për njohjen, legalizimin ose apostilimin e dokumenteve të huaja dhe përkthimin e tyre në gjuhën shqipe, përveç rasteve kur legjislacioni ose marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme parashikojnë ndryshe.

KREU II – APLIKIMI DHE DOKUMENTACIONI

Neni 11

Mënyra e paraqitjes së aplikimit

1. Kërkesa për pajisjen me licencë, së bashku me dokumentacionin përkatës, paraqitet pranë ERE-s nëpërmjet dorëzimit në protokollin e institucionit ose dërgimit me postë elektronike në adresën zyrtare të internetit të ERE-s apo në një platformë digjitale. Kërkesa regjistrohet dhe administrohet në përputhje me rregullat në fuqi për administrimin e dokumentacionit.

2. Aplikimi përmban formularin e nënshkruar, dokumentet e përgjithshme dhe specifike, deklaratat dhe provën e pagesës së aplikimit.

Neni 12

Dokumentacioni i përgjithshëm

1. Aplikuesi paraqet:

   a) të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit;
   b) strukturën e pronësisë dhe të kontrollit, deri te pronari përfitues kur kërkohet;
   c) administratorët dhe organet drejtuese;
   d) organizimin dhe personelin kyç;
   e) deklarimin e saktësisë së informacionit dhe autenticitetit të tij.

2. Aplikuesi paraqet pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse.

3. Në rastin e aplikimit për licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, kur impianti ndodhet në fazën përfundimtare të ndërtimit, aplikuesi paraqet informacion mbi ecurinë dhe nivelin e realizimit të investimit, të shoqëruar me kopje të informacioneve dhe raportimeve të paraqitura pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë lidhur me realizimin e investimit dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi ose akti përkatës i miratimit.

4. ERE nuk kërkon dokumente që mund t’i sigurojë drejtpërdrejt nga regjistrat publikë në përputhje me ligjin.

5. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet e huaja paraqiten të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të pajisura me apostile ose të legalizuara, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme.

Neni 13

Vlerësimi i përmbushjes së kushteve dhe kritereve të licencimit

ERE verifikon përmbushjen e kërkesave ligjore nga aplikuesi, përvojën në ushtrimin e veprimtarisë përkatëse të stafit teknik, disponueshmërinë e burimeve financiare dhe teknike, si dhe dokumentacionin që provon aftësinë për të ushtruar veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca.

Neni 14

Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

1. Për pajisjen me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet dokumentacionin teknik dhe ligjor që përmban të dhënat identifikuese dhe karakteristikat kryesore të impiantit të prodhimit, përfshirë burimin energjetik që do të shfrytëzohet, vendndodhjen, fuqinë e instaluar dhe projektin teknik të impiantit, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 3. Dokumentacioni shoqërohet me aktet e autorizimit ose miratimit të investimit, dokumentacionin që vërteton miratimin e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike, si dhe lejet dhe autorizimet mjedisore, të përdorimit të burimeve ujore apo të tjera, kur këto kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

2. Në rastet kur impianti i prodhimit përfshin edhe një sistem të integruar të depozitimit të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, të dhëna të veçanta për sistemin e depozitimit, duke specifikuar fuqinë nominale të instaluar, kapacitetin energjetik të depozitimit, karakteristikat kryesore teknike, skemën e lidhjes dhe integrimit me impiantin e prodhimit, si dhe mënyrën e parashikuar të operimit. Dokumentacioni duhet të evidentojë gjithashtu ndikimin e integrimit të sistemit të depozitimit në kapacitetin e autorizuar të impiantit, kushtet e lidhjes me rrjetin dhe kushtet e licencës së prodhimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 55 të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 15

Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtaritë e operimit të sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes dhe sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike

1. Për licencimin në veprimtarinë e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet informacionin dhe dokumentacionin teknik që përmban përshkrimin e sistemit të transmetimit, skemën e rrjetit dhe elementet përbërëse të tij, karakteristikat dhe kapacitetet teknike të aseteve, si dhe të dhënat mbi zonën dhe shtrirjen e veprimtarisë sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 4 (A). Gjithashtu, paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të aseteve, planin e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit, programin e operimit dhe mirëmbajtjes, strukturën organizative dhe numrin e personelit teknik të angazhuar, si dhe informacionin mbi sistemet e matjes, monitorimit, komunikimit dhe teknologjisë së informacionit. Aplikuesi paraqet gjithashtu informacion mbi masat e marra për garantimin e sigurisë, besueshmërisë dhe vazhdimësisë së operimit të sistemit, në përputhje me kodet e rrjetit dhe kërkesat teknike e rregullatore në fuqi.

2. Për licencimin në veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, aplikuesi paraqet përshkrimin e sistemit të shpërndarjes, skemën e rrjetit, elementet përbërëse të tij, karakteristikat teknike dhe kapacitetet e aseteve, si dhe përcaktimin e zonës së shërbimit, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 4 (A). Dokumentacioni përfshin gjithashtu provat e pronësisë ose të drejtës së përdorimit të aseteve, planin e zhvillimit dhe investimeve në rrjet, programin e operimit dhe mirëmbajtjes, planin e reduktimit të humbjeve teknike dhe joteknike, si dhe masat dhe objektivat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Aplikuesi paraqet të dhëna mbi personelin teknik dhe organizimin e funksioneve operative, sistemet e matjes dhe monitorimit, infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, si dhe masat e sigurisë dhe të garantimit të vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike.

3. Për sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, aplikuesi paraqet dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve ligjore për klasifikimin e sistemit si sistem i mbyllur shpërndarjeje, së bashku me përshkrimin dhe skemën e rrjetit, elementet përbërëse të tij, zonën e shërbimit, burimin e furnizimit me energji elektrike dhe të dhënat mbi përdoruesit e sistemit, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 4 (B). Gjithashtu, paraqiten dokumentet që vërtetojnë të drejtën e përdorimit të infrastrukturës, mënyrën e operimit dhe administrimit të sistemit, si dhe përmbushjen e kërkesave teknike dhe të sigurisë, në përputhje me klasifikimin dhe regjimin e posaçëm të përcaktuar në ligjin nr. 59/2026.

Neni 16
Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

1. Për licencimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet planin e parashikuar të ushtrimit të veprimtarisë, ku përfshihen numri dhe kategoritë e klientëve që synon të furnizojë, vëllimi i parashikuar i energjisë elektrike, burimet dhe mënyrat e sigurimit të energjisë, si dhe marrëveshjet ose kontratat e parashikuara për blerjen e saj, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 5. Gjithashtu, paraqitet informacion mbi mënyrën e menaxhimit të portofolit të klientëve, mbulimin e riskut të çmimeve dhe të tregut, si dhe kapacitetet financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga veprimtaria e furnizimit.

2. Aplikuesi paraqet informacion mbi organizimin e funksioneve të furnizimit dhe burimet njerëzore e teknike të parashikuara për ushtrimin e veprimtarisë, përfshirë sistemin e faturimit, administrimin e kontratave, komunikimin dhe shërbimin ndaj klientëve, procedurat për trajtimin e kërkesave dhe ankesave, si dhe masat për mbrojtjen dhe administrimin e të dhënave të klientëve.

3. Aplikuesi paraqet informacion mbi mënyrën e përmbushjes së detyrimeve të balancimit, përgjegjësitë në tregun e energjisë elektrike dhe zbatimin e rregullave të tregut.

4. Aplikuesi paraqet gjithashtu informacion mbi masat dhe procedurat e parashikuara për garantimin e vazhdimësisë së furnizimit, përmbushjen e detyrimeve kontraktore ndaj klientëve dhe respektimin e kërkesave për mbrojtjen e klientëve, përfshirë klientët në nevojë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike

1. Për licencimin në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet përshkrimin e organizimit dhe funksionimit të tregut, procedurat për regjistrimin dhe pranimin e pjesëmarrësve, administrimin e ofertave dhe kërkesave për blerje e shitje të energjisë elektrike, si dhe mekanizmat për përputhjen dhe ekzekutimin e transaksioneve, sipas rregullave të tregut, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 6.

2. Aplikuesi paraqet informacion mbi sistemet informatike dhe infrastrukturën teknike të nevojshme për administrimin dhe operimin e tregut, përfshirë sistemet e komunikimit, përpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave, sigurinë e informacionit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe masat për garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemeve.

3. Aplikuesi paraqet procedurat për administrimin e rezultateve të tregut, llogaritjen dhe publikimin e çmimeve, shlyerjen dhe rakordimin e transaksioneve, si dhe raportimin e informacionit pranë ERE-s dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, në përputhje me rregullat e tregut dhe legjislacionin në fuqi.

4. Aplikuesi paraqet strukturën organizative dhe ndarjen e përgjegjësive për funksionet e operimit të tregut, procedurat e kontrollit të brendshëm dhe mekanizmat për monitorimin e aktivitetit të pjesëmarrësve, evidentimin e parregullsive dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave të tregut.

5. Aplikuesi paraqet politikat dhe procedurat për identifikimin, parandalimin dhe administrimin e konflikteve të interesit, ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit tregtar dhe garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues të pjesëmarrësve në treg.

6. Aplikuesi paraqet informacion mbi burimet njerëzore, kapacitetet teknike dhe financiare.

Neni 18

Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtarinë e operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike të lidhura në rrjetin e transmetimit

1. Për licencimin në veprimtarinë e operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, aplikimi përmban dokumentacionin teknik dhe ligjor që përmban vendndodhjen e impiantit, teknologjinë e përdorur, fuqinë nominale të instaluar (MW), kapacitetin energjetik të depozitimit (MWh), kohëzgjatjen e shkarkimit, eficiencën e impiantit, fuqinë maksimale të karikimit dhe të shkarkimit, projektin Teknik, skemën e lidhjes së impiantit me rrjetin dhe

pikën e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike, karakteristikat e pajisjeve kryesore, sistemet e kontrollit dhe monitorimit, mënyrën e parashikuar të operimit dhe shërbimet që impianti synon të ofrojë në tregun e energjisë elektrike dhe në sistem, sipas rastit, sikurse kërkuar në Aenkset 1, 2 dhe 7.

2. Aplikuesi duhet të paraqesë gjithashtu aktin e miratimit të ndërtimit të kapacitetit të depozitimit të energjisë elektrike, të lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose nga Këshilli i Ministrave, sipas kompetencës së përcaktuar në nenin 52, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe depozituese, të miratuara në zbatim të pikës 2 të këtij neni, kur projekti i nënshtrohet detyrimit për pajisje me autorizim sipas këtyre dispozitave Gjithashtu, paraqiten aktet e përfundimit të procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe lejen mjedisore, sipas rastit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Dokumentacioni përfshin gjithashtu informacion mbi masat e sigurisë teknike dhe elektrike, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, zbulimit dhe parandalimit të mbinxehjes, planin e reagimit ndaj emergjencave, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e baterive në fund të ciklit të tyre të përdorimit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4. Aplikuesi paraqet dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të impiantit (sipas aktit përkatës, miratimi i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, akti i privatizimit apo dokumentacioni përkatës që provon kalimin e së drejtës së pronësisë etj.), kapacitetin financiar për ndërtimin dhe operimin e tij, disponueshmërinë e personelit teknik të kualifikuar, si dhe dokumentacionin që vërteton miratimin e kushteve të lidhjes me rrjetin ose marrëveshjet përkatëse për përdorimin e tij.

5. Në rastin e impianteve të depozitimit të integruara me impiantet e prodhimit të energjisë elektrike, aplikuesi paraqet dokumentacionin që identifikon veçmas karakteristikat teknike të sistemit të depozitimit, mënyrën e integrimit dhe të operimit të tij.

6. Për impiantet që ndodhen në fazën e projektimit ose të ndërtimit, të cilët janë rregjistruar më parë në ERE, aplikuesi paraqet dokumentacionin që vërteton ecurinë e projektit, ndërsa për impiantet që janë përfunduar dhe ndodhen në operim, paraqitet dokumentacioni teknik përfundimtar, aktet e kolaudimit dhe dokumentacioni që vërteton gatishmërinë teknike për operim që përfshin:
   a) Akti i kolaudimit të impiantit, kur kërkohet nga legjislacioni.
   b) Procesverbalet e provave dhe testimeve teknike të pajisjeve dhe sistemit.
   c) Dokumentacioni që konfirmon përmbushjen e kushteve teknike të lidhjes me rrjetin.
   d) Akti i marrjes në dorëzim të punimeve dhe pajisjeve, sipas rastit.

Neni 19

Dokumentacioni i kërkuar për licencim në veprimtarinë e agregimit të energjisë elektrike

1. Për licencimin në veprimtarinë e agregimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të paraqesë Planin e biznesit dhe përshkrimin e mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë, duke përcaktuar kategoritë e burimeve të prodhimit, impianteve të depozitimit dhe klientëve që synon të agregojë, kapacitetet e parashikuara për agregim, si dhe mënyrën e organizimit dhe administrimit të portofolit të agreguar, sikurse kërkuar në Anekset 1, 2 dhe 8.

2. Aplikuesi paraqet informacion mbi sistemet teknike dhe informatike që përdoren për komunikimin, matjen, monitorimin dhe administrimin e të dhënave të burimeve dhe klientëve të agreguar, si dhe procedurat për shkëmbimin dhe përpunimin e informacionit me operatorët e sistemit dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

3. Aplikuesi paraqet modelin e kontratave dhe procedurat që rregullojnë marrëdhënien me klientët dhe burimet e agreguara, përfshirë kushtet e pjesëmarrjes, informimin paraprak, marrjen e pëlqimit të klientëve, përcaktimin e përgjegjësive të palëve, mënyrën e llogaritjes dhe kompensimit për energjinë ose fleksibilitetin e ofruar, si dhe procedurat për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

4. Aplikuesi paraqet informacion mbi mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive të balancimit, përfshirë marrëveshjet me palët përgjegjëse për balancimin, procedurat për parashikimin dhe administrimin e devijimeve, si dhe mënyrën e koordinimit me operatorët e sistemit dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

5. Aplikuesi paraqet dokumentacionin që provon kapacitetet financiare, organizative dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe procedurat për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, mbrojtjen e informacionit tregtar dhe trajtimin jodiskriminues të klientëve dhe pjesëmarrësve në treg. Aplikuesi paraqet dokumentacionin që përfshin:
   a) strukturën organizative të subjektit dhe ndarjen e përgjegjësive për administrimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së agregimit;
   b) të dhëna mbi personelin përgjegjës për veprimtarinë, kualifikimet dhe përvojën e tij profesionale në sektorin e energjisë elektrike;
   c) pasqyrat financiare dhe dokumentacionin që vërteton burimet dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë;
   d) procedurat për administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave të klientëve dhe burimeve të agreguara, përfshirë masat për parandalimin e aksesit të paautorizuar dhe përcaktimin e niveleve të aksesit në informacion;
   e) procedurat për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit tregtar dhe të dhënave të klientëve;
   f) rregullat dhe procedurat për pranimin, administrimin dhe trajtimin e klientëve dhe pjesëmarrësve në portofolin e agreguar, mbi kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Neni 20

Dokumentacioni i kërkuar për licencim për operimin e pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike të aksesueshme nga publiku

1. Aplikimi per licencë për operimin e pikave te rikarikimit te autojeteve elektrike paraqitet kur aplikuesi ka nje pikë rikarikimi, e cila është një ndërfaqe e aksesueshme nga publiku, që është në gjendje të karikojë njërin automjet elektrik pas tjetrit ose të shkëmbejë baterinë e njërit automjeti elektrik pas tjetrit.

2. Aplikuesi për ushtrimin e veprimtarisë së operimit të pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike paraqet dokumentacionin ligjor, teknik, organizativ dhe financiar që vërteton aftësinë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2026 dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm, sikurse kërkuar në Aneksin 1, 2 dhe 10.

3. Dokumentacioni teknik përfshin:
   a) përshkrimin e projektit dhe informacionin mbi numrin, vendndodhjen dhe karakteristikat e pikave të rikarikimit që aplikuesi synon të operojë;
   b) të dhënat teknike të pajisjeve të rikarikimit, duke përfshirë fuqinë nominale, kapacitetin, teknologjinë e përdorur, llojin e lidhësve dhe mënyrën e funksionimit;
   c) skemën elektrike të instalimit dhe skemën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, duke përcaktuar nivelin e tensionit, fuqinë e kërkuar dhe kapacitetin e nevojshëm të lidhjes;
   d) miratimin e lidhjes me rrjetin dhe marrëveshjen përkatëse me operatorin e sistemit, sipas rastit;
   e) projektin teknik të instalimit, përfshirë pajisjet mbrojtëse, sistemin e tokëzimit, mbrojtjen nga mbingarkesat dhe qarqet e shkurtra, si dhe masat për garantimin e sigurisë elektrike;
   f) dokumentacionin që vërteton përputhshmërinë e pajisjeve dhe instalimeve me standardet teknike dhe të sigurisë në fuqi;
   g) dokumentacionin mbi sistemin e matjes së energjisë elektrike të furnizuar për rikarikim, pajisjet e komunikimit dhe sistemet e administrimit të të dhënave;
   h) përshkrimin e mënyrës së operimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të pikave të rikarikimit, si dhe procedurat për trajtimin e defekteve dhe situatave të emergjencës;
   i) dokumentacionin që vërteton gatishmërinë teknike të pajisjeve për operim, sipas fazës së zhvillimit të projektit dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4. Përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, aplikuesi paraqet:
   a) dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të vendndodhjes dhe aseteve që përdoren për ushtrimin e veprimtarisë;
   b) planin e biznesit dhe parashikimin e kostove të investimit dhe operimit;
   c) dokumentacionin që vërteton kapacitetin financiar për zhvillimin dhe vijimin e veprimtarisë;
   d) strukturën organizative dhe informacionin mbi personelin përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;
   e) informacionin mbi mënyrën e sigurimit të energjisë elektrike, marrëdhëniet me furnizuesin dhe kushtet e ofrimit të shërbimit për përdoruesit;

f) procedurat për faturimin, administrimin e pagesave, informimin e përdoruesve dhe trajtimin e ankesave.

5. Në rastin kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kërkon të zotërojë, zhvillojë, menaxhojë ose operojë një pikë rikarikimi, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm:
   a) relacionin shpjegues mbi nevojën për përfshirjen e OSSH-së në zhvillimin ose operimin e pikës së rikarikimit;
   b) dokumentacionin që vërteton se palët e treta nuk kanë shprehur interes për zotërimin, zhvillimin, menaxhimin ose operimin e pikës së rikarikimit, ose nuk mund ta ofrojnë këtë shërbim me kosto të arsyeshme dhe brenda një kohe të përshtatshme;
   c) analizën teknike dhe ekonomike që argumenton nevojën për përfshirjen e OSSH-së dhe përmbushjen e parimit të kostos më të ulët të mundshme;
   d) projektin teknik, të dhënat mbi vendndodhjen, fuqinë e instaluar, skemën e lidhjes me rrjetin dhe karakteristikat e pajisjeve të rikarikimit;
   e) dokumentacionin e procedurës së tenderimit, përfshirë kriteret e pjesëmarrjes, kriteret e përzgjedhjes, mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe projektkontratën përkatëse;
   f) informacionin mbi mënyrën e garantimit të aksesit të palëve të treta dhe trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të sistemit dhe kategorive të tyre.

6. ERE shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga OSSH dhe vlerëson përmbushjen e kushteve të nenit 80 të ligjit nr. 59/2026, përpara miratimit paraprak të kushteve të procedurës së tenderimit.

7. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në përputhje me fazën e zhvillimit të projektit.

Neni 21

Procedura për licencimin e pikave të rikarikimit të aksesueshme nga publiku në operim

1. Për pikat e rikarikimit të automjeteve elektrike që janë në operim në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, subjektet që i zotërojnë ose i operojnë paraqesin pranë ERE-s kërkesën për pajisjen me licencë.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin që vërteton statusin juridik të operatorit, të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të pikave të rikarikimit, karakteristikat teknike të pajisjeve, miratimin e lidhjes me rrjetin elektrik dhe dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kërkesave teknike dhe të sigurisë për vijimin e operimit.

3. Për pikat e rikarikimit që janë në operim, nuk kërkohet riparaqitja e dokumentacionit të plotë të projektimit dhe ndërtimit. ERE vlerëson dokumentacionin që vërteton gjendjen teknike, sigurinë elektrike, përputhshmërinë me kushtet e lidhjes në rrjet dhe gatishmërinë për vijimin e operimit.

Neni 22

Licencimi i klientëve aktivë

1. Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari si klientë aktivë, për të cilat kërkohet licencim sipas nenit 40 të ligjit nr. 59/2026 dhe që nuk përfshihen në rastet e përjashtimit nga licencimi të parashikuara në këtë ligj, paraqesin pranë ERE-s kërkesën për pajisjen me licencën përkatëse, sipas natyrës së veprimtarisë që ushtrojnë.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e përgjithshëm dhe të posaçëm të përcaktuar në këtë rregullore për veprimtarinë përkatëse, me dokumentacionin që vërteton:
   a) statusin e aplikuesit si klient fundor dhe veprimtarinë që ushtron në cilësinë e klientit aktiv;
   b) pronësinë ose të drejtën e përdorimit të instalimeve të prodhimit dhe/ose depozitimit të energjisë elektrike;
   c) karakteristikat teknike të instalimeve, fuqinë e instaluar, kapacitetin energjetik dhe vendndodhjen e tyre;
   d) kushtet e lidhjes me rrjetin dhe dokumentacionin e sistemit të matjes së energjisë elektrike të konsumuar dhe asaj të injektuar në rrjet;
   e) mënyrën e përmbushjes së përgjegjësisë së balancimit ose marrëveshjen për delegimin e saj, kur është e zbatueshme;
   f) marrëveshjet dhe kontratat e lidhura për shitjen e energjisë elektrike, agregimin ose pjesëmarrjen në skemat e fleksibilitetit.
   g) Për klientët aktivë që kanë në pronësi ose përdorin impiante prodhimi apo depozitimi të energjisë elektrike, të cilat përfshihen në rastet e përjashtuara nga licencimi sipas nenit 40 të ligjit nr. 59/2026, nuk kërkohet pajisja me licencë për këto veprimtari.

Neni 23

Licencimi për komunitetet energjetike të qytetarëve

1. Komunitetet energjetike të qytetarëve që aplikojnë për licencim për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr. 59/2026, për të cilat nuk parashikohet përjashtim nga detyrimi për licencim, paraqesin dokumentacionin e përgjithshëm dhe të posaçëm të përcaktuar në këtë rregullore për veprimtarinë përkatëse.
2. Përveç dokumentacionit të kërkuar për veprimtarinë përkatëse, aplikuesi paraqet:
   a) aktin e themelimit, statutin dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e komunitetit si person juridik, sipas formës së organizimit të lejuar nga legjislacioni në fuqi;
   b) listën e anëtarëve ose aksionarëve të komunitetit, me të dhënat identifikuese dhe informacionin mbi pjesëmarrjen e tyre në komunitet;
   c) dokumentacionin që përcakton strukturën organizative dhe drejtuese, organet vendimmarrëse dhe kompetencat e tyre;
   d) rregullat e brendshme për pranimin dhe largimin e anëtarëve, si dhe për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre në komunitet;
   e) dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kërkesave për pjesëmarrjen e hapur dhe vullnetare, si dhe mënyrën e ushtrimit të kontrollit nga anëtarët ose aksionarët e komunitetit;

f) përshkrimin e veprimtarive energjetike që komuniteti synon të ushtrojë, përfshirë prodhimin, konsumin, depozitimin, ndarjen, shitjen e energjisë elektrike ose agregimin, sipas rastit;
g) dokumentacionin teknik për impiantet e prodhimit dhe/ose depozitimit që përdoren nga komuniteti, përfshirë fuqinë e instaluar, kapacitetin energjetik, teknologjinë, vendndodhjen dhe skemën e lidhjes me rrjetin;
h) dokumentacionin që përcakton mënyrën e ndarjes së energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve, administrimin e të dhënave të matjes dhe përllogaritjen e përfitimeve përkatëse;
i) dokumentacionin që vërteton mënyrën e përmbushjes së përgjegjësisë së balancimit ose delegimin e saj, kur është e zbatueshme;
j) informacionin mbi mënyrën e administrimit dhe shpërndarjes së përfitimeve ekonomike, sociale ose mjedisore që rrjedhin nga veprimtaria e komunitetit.

3. Për komunitetet e energjisë së rinovueshme, përpara paraqitjes së kërkesës për licencim, duhet të jetë përfunduar procedura e regjistrimit pranë ERE-s, në përputhje me rregulloren e posaçme për regjistrimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme. Dokumentacioni që vërteton regjistrimin dhe të dhënat e administruara gjatë kësaj procedure merren në konsideratë gjatë shqyrtimit të kërkesës për licencim dhe nuk kërkohet të riparaqiten, përveç rasteve kur kanë pësuar ndryshime ose nevojitet përditësimi i tyre.

4. Kur komuniteti energjetik kërkon licencim për më shumë se një veprimtari, dokumentacioni plotësohet me kërkesat e posaçme të përcaktuara në këtë rregullore për secilën veprimtari përkatëse.

5. Për veprimtaritë që përjashtohen shprehimisht nga detyrimi për licencim sipas nenit 40 të ligjit nr. 59/2026, komuniteti energjetik nuk është i detyruar të paraqesë kërkesë për licencim për këto veprimtari, pa cenuar detyrimet e tjera ligjore dhe rregullatore që zbatohen për to.

Neni 24

Fillimi i procedurës dhe njoftimi publik

1. Struktura përgjegjëse për licencimin shqyrton aplikimin dhe dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe përgatit propozimin përkatës për fillimin ose mosfillimin e procedurës së shqyrtimit të aplikimit, të cilin ia paraqet Bordit të ERE-s për vendimmarrje.

2. Bordi i ERE-s vendos për mosfillimin e procedurës së licencimit në rastet kur:
a) aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacionin thelbësor që përbën kusht paraprak ligjor për zhvillimin ose ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
b) aplikuesi nuk ka kryer pagesën e e aplikimit për licencim, të miratuar nga ERE.

3. Në rastin e mospagesës së aplikimit, struktura përgjegjëse për licencimin njofton me shkrim aplikuesin, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës, për të kryer pagesën përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se aplikuesi nuk

kryen pagesën brenda këtij afati, struktura përgjegjëse i propozon Bordit të ERE-s mosfillimin e procedurës së licencimit.

4. Dokumentacion thelbësor i aplikimit konsiderohet:
   a) për prodhimin dhe depozitimin e energjisë elektrike, akti i miratimit të ndërtimit të kapacitetit përkatës, i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, sipas rasteve të parashikuara në nenin 52 të ligjit nr. 59/2026;
   b) për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, dokumentacioni që vërteton të drejtën e aplikuesit për të operuar dhe administruar asetet e rrjetit për të cilat kërkohet licenca;
   c) për veprimtaritë e tjera, aktet e miratimit, autorizimet ose dokumentet e tjera sipas natyrës së veprimtarisë.

5. Kur aplikimi përmban dokumentacionin thelbësor për shqyrtimin e kërkesës, por konstatohen mangësi ose nevojitet dokumentacion plotësues, Bordi i ERE-s vendos për fillimin e procedurës së licencimit dhe përcakton dokumentet që duhet të plotësohen, si dhe afatin për paraqitjen e tyre.

6. Në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 59/2026, ERE publikon njoftimin për aplikimin për licencim brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit.

7. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të ERE-s dhe në median e shkruar, për dy ditë radhazi, në dy gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin, që botohen në Tiranë.

8. Njoftimi përmban emrin e aplikuesit, objektin e kërkesës, veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca, vendndodhjen dhe kapacitetin e impiantit, kur këto të dhëna janë të zbatueshme, si dhe informacionin për mënyrën dhe afatin e paraqitjes së vërejtjeve dhe kundërshtimeve nga institucionet publike dhe palët e interesuara.

9. Afati për paraqitjen e komenteve, kundërshtimeve apo opinioneve është:
   a) 30 (tridhjetë) ditë nga data e parë e publikimit të njoftimit, për aplikimet për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për impiantet e lidhura me rrjetin e transmetimit;
   b) 10 (dhjetë) ditë nga data e parë e publikimit të njoftimit, për aplikimet për licencim në veprimtarinë e prodhimit për impiantet e lidhura me rrjetin e shpërndarjes dhe për aplikimet për veprimtaritë e tjera.
10. Pas publikimit të njoftimit për aplikimin, ERE administron komentet, kundërshtimet apo opinionet e paraqitura nga institucionet publike dhe palët e interesuara, brenda afatit të përcaktuar në njoftimin përkatës.

11. Struktura përgjegjëse për licencimin shqyrton përmbajtjen e tyre dhe vlerëson lidhjen me objektin e aplikimit, bazueshmërinë ligjore dhe faktike, si dhe ndikimin e tyre në përmbushjen e kushteve të licencimit.

12. Komentet, kundërshtimet apo opinionet që lidhen me kërkesën për licencim i përcillen aplikuesit, duke i lënë një afat prej 10 (dhjetë) ditësh pune për të paraqitur shpjegimet dhe qëndrimin e tij.

13. Kur nga shqyrtimi i komenteve, kundërshtimeve apo opinioneve rezulton e nevojshme marrja e informacionit apo dokumentacionit shtesë, struktura përgjegjëse mund t'i kërkojë aplikuesit paraqitjen e tyre, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

14. Pas shqyrtimit të komenteve, kundërshtimeve, opinioneve dhe qëndrimit të aplikuesit, struktura përgjegjëse pasqyron në relacionin përfundimtar përmbajtjen e tyre, vlerësimin e kryer dhe propozimin përkatës për vendimmarrje.

15. Bordi i ERE-s, gjatë marrjes së vendimit përfundimtar, shqyrton komentet, kundërshtimet apo opinionet arsyeshme dhe të bazuara, si dhe arsyeton në vendim pranimin ose mospranimin e tyre, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 59/2026.

Neni 25

Seancat dëgjimore dhe palët e interesuara

1. ERE mund të zhvillojë seancë dëgjimore kur natyra e çështjes, komentet, kundërshtimet, opinionet ose interesat e palëve e bëjnë të nevojshme.

2. Procesverbali, komentet dhe qëndrimi i ERE-s për çështjet thelbësore bëhen pjesë e dosjes, duke respektuar konfidencialitetin.

Neni 26

Afatet procedurale

1. Afati për përfundimin e procedurës së licencimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar nga Bordi i ERE-s është:
   a) 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit, për aplikimet për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për impiantet e lidhura me rrjetin e transmetimit;
   b) 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit, për aplikimet për licencim në veprimtarinë e prodhimit për impiantet e lidhura me rrjetin e shpërndarjes, si dhe për aplikimet për të gjitha veprimtaritë e tjera.

2. Gjatë shqyrtimit të aplikimit, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit paraqitjen e informacionit ose dokumentacionit shtesë, duke përcaktuar afatin brenda të cilit duhet të paraqiten. Kur shtyrja e afatit kërkohet nga aplikuesi, kërkesa duhet të jetë e arsyetuar dhe të përcaktojë periudhën e shtyrjes së kërkuar. Aplikuesi ka detyrimin të paraqesë, së bashku me dokumentacionin plotësues, çdo akt, miratim, autorizim ose dokument tjetër të përditësuar, vlefshmëria ose

përmbajtja e të cilit ka ndryshuar gjatë periudhës së shtyrjes, si dhe të informojë ERE-n për çdo ndryshim që ndikon në kushtet dhe kriteret e licencimit.

3. Në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes ose nevojës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe informacionit shtesë, Bordi i ERE-s mund të vendosë zgjatjen e afatit të vendimmarrjes vetëm një herë, deri në 30 (tridhjetë) ditë pune. Vendimi për zgjatjen e afatit dhe arsyet përkatëse i njoftohen aplikuesit përpara përfundimit të afatit fillestar.

4. Pezullimi i procedurës ose i afateve procedurale bëhet vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në legjislacionin e posaçëm. Pezullimi, zgjatja ose rifillimi i afatit pasqyrohet në dosjen administrative dhe i njoftohet aplikuesit, duke përcaktuar arsyen dhe kohëzgjatjen përkatëse.

5. Në përfundim të shqyrtimit, Bordi i ERE-s merr vendimin për dhënien ose refuzimin e licencës brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2026.

Neni 27

Vendimmarrja dhe arsyetimi

1. Bordi vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës, duke identifikuar bazën ligjore, faktet e provuara, kriteret e vlerësuara dhe arsyet e vendimmarrjes.

2. Vendimi përcakton afatin dhe kushtet e licencës, detyrimet përpara fillimit të operimit kur zbatohen, publikimin dhe mjetet e ankimit.

Neni 28

Licenca me kusht

1. ERE mund të japë licencë me kusht vetëm për kërkesa që nuk përbëjnë pengesë ligjore ose rrezik të papranueshëm për sigurinë dhe ushtrimin e veprimtarisë.

2. Vendimi përcakton kushtin konkret, arsyetimin, afatin e plotësimit, provat dhe pasojat e mosplotësimit.

Neni 29

Refuzimi i kërkesës

1. Kërkesa refuzohet kur aplikuesi nuk plotëson kushtet ligjore ose kriteret e detyrueshme të licencimit, pas garantimit të të drejtës për t’u dëgjuar në rastet e parashikuara nga ligji.

2. Refuzimi përmban shkaqet konkrete dhe informacionin për mjetet e ankimit; aplikimi i ri vlerësohet mbi dokumentacionin dhe rrethanat e paraqitura në atë kohë.

Neni 30
Modifikimi i licencës

1. Modifikimi i licencës mund të kërkohet nga i licencuari ose të iniciohet nga ERE, në rastet kur ndryshojnë të dhënat, karakteristikat teknike ose kushtet e përcaktuara në licencën e miratuar, si dhe kur lind nevoja për përshtatjen e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2. I licencuari paraqet kërkesë për modifikimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, operimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike dhe agregimin kur ndryshimet prekin elementet e saj, sipas përcaktimeve të Aneksit 9, përfshirë:
   a) ndryshimin e fuqisë së instaluar ose të kapacitetit të licencuar;
   b) ndryshimin e vendndodhjes së impiantit ose të aseteve që përdoren për ushtrimin e veprimtarisë;
   c) ndryshimin e teknologjisë ose të karakteristikave kryesore teknike të impiantit;
   d) shtimin, heqjen ose zëvendësimin e impianteve dhe pajisjeve që ndikojnë në kushtet e licencimit;
   e) ndryshimin e kushteve të tjera të licencës, për të cilat kërkohet miratimi i ERE-s sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kur modifikimi i licencës iniciohet nga ERE, struktura përgjegjëse për licencimin përgatit relacionin dhe propozimin përkatës, të cilat i paraqiten Bordit të ERE-s për shqyrtim dhe vendimmarrje mbi fillimin e procedurës së modifikimit. Në këto raste, i licencuari njoftohet për arsyet dhe ndryshimet e propozuara, si dhe për dokumentacionin ose shpjegimet që duhet të paraqesë.

4. Kërkesa për modifikimin e licencës shoqërohet me dokumentacionin që vërteton ndryshimin e propozuar, arsyet e tij dhe ndikimin në kushtet teknike, financiare dhe organizative të ushtrimit të veprimtarisë, sipas natyrës së modifikimit të kërkuar, si dhe me lejet, miratimet, autorizimet apo aktet e tjera përkatëse, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi për realizimin e ndryshimit të propozuar, sipas natyrës së modifikimit dhe veprimtarisë së licencuar.

5. Në rastet e modifikimit të licencës, qoftë me kërkesë të të licencuarit apo me iniciativën e ERE-s, pas vendimit për fillimin e procedurës, ERE publikon njoftimin përkatës në faqen zyrtare dhe në dhe në median e shkruar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore, duke përcaktuar objektin e modifikimit dhe afatin për paraqitjen e vërejtjeve dhe kundërshtimeve nga institucionet publike dhe palët e interesuara.

6. I licencuari nuk është i detyruar të ridorëzojë dokumentacionin që nuk preket nga modifikimi i kërkuar dhe që ndodhet në dosjen e licencimit pranë ERE-s, me kusht që ky dokumentacion të jetë ende i vlefshëm dhe të mos ketë ndryshuar.

7. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit, struktura përgjegjëse për licencimin përgatit relacionin përfundimtar dhe propozimin përkatës, duke pasqyruar edhe vërejtjet dhe

kundërshtimet e paraqitura. Bordi i ERE-s vendos për miratimin ose refuzimin e modifikimit të licencës.

Neni 31

Depozitimi i integruar me prodhimin

1. I licencuari në prodhimin e energjisë elektrike mund të zotërojë, zhvillojë, menaxhojë dhe operojë impiante të depozitimit të energjisë elektrike në përputhje me të drejtat e parashikuara në nenin 55, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 59/2026.

2. Kur impianti i depozitimit integrohet me impiantin ekzistues të prodhimit dhe funksionon si pjesë e të njëjtit konfigurim teknik dhe operacional, i licencuari paraqet pranë ERE-s kërkesën për modifikimin e licencës dhe përditësimin e aneksit teknik përkatës.

3. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin teknik të impiantit të depozitimit, ku përcaktohen fuqia nominale (MW), kapaciteti energjetik (MWh), skema e lidhjes me rrjetin, mënyra e karikimit dhe shkarkimit, mënyra e operimit dhe integrimi i tij me impiantin e prodhimit, si dhe dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kushteve teknike dhe të sigurisë.

4. I licencuari paraqet aktin e miratimit ose autorizimit për ndërtimin e kapacitetit të depozitimit, të lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 52 të ligjit nr. 59/2026, kur ky miratim kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ERE vlerëson përputhshmërinë e konfigurimit të propozuar me kushtet e licencës ekzistuese, kushtet e lidhjes me rrjetin dhe kërkesat teknike e të sigurisë. Kur ndryshimet prekin kushtet e autorizimit të ndërtimit ose çështje që lidhen me kompetencat e ministrisë përgjegjëse për energjinë, ERE i kërkon kësaj të fundit mendimin përkatës përpara marrjes së vendimit.

6. Modifikimi i licencës dhe përditësimi i aneksit teknik miratohen me vendim të Bordit të ERE-s, pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 32

Rinovimi i licencës

1. I licencuari që kërkon rinovimin e licencës paraqet kërkesën pranë ERE-s jo më vonë se 4 (katër) muaj dhe jo më herët se 6 (gjashtë) muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj. Kërkesa shoqërohet me formularin përkatës të aplikimit, dokumentacionin ligjor, financiar dhe teknik që ka pësuar ndryshime, informacionin mbi veprimtarinë e ushtruar gjatë periudhës së licencimit, si dhe dokumentacionin tjetër që kërkohet nga kjo rregullore.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rinovim, ERE vlerëson përmbushjen e kushteve të licencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj, historikun e pajtueshmërisë së të licencuarit me legjislacionin dhe aktet rregullatore, përmbushjen e detyrimeve ndaj ERE-s dhe institucioneve

të tjera, gjendjen teknike dhe financiare të subjektit, si dhe kapacitetin e tij për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë.

3. Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës, ERE mund t'i kërkojë të licencuarit informacion ose dokumentacion shtesë lidhur me veprimtarinë e ushtruar, përmbushjen e detyrimeve të licencës dhe ndryshimet e ndodhura gjatë periudhës së licencimit.

4. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur gjatë procedurës së licencimit ose rinovimit të mëparshëm nuk ka pësuar ndryshime dhe është ende i vlefshëm, i licencuari nuk është i detyruar ta ridorëzojë atë, por mund t'i referohet dokumentacionit të administruar në dosjen e licencimit pranë ERE-s.

5. Rinovimi i licencës shqyrtohet sipas kritereve të zbatueshme për dhënien e saj, duke marrë në konsideratë edhe rezultatet e monitorimit të veprimtarisë dhe përmbushjen e kushteve të licencës gjatë periudhës së mëparshme.

6. ERE publikon njoftimin për kërkesën e rinovimit të licencës dhe administron vërejtjet dhe kundërshtimet e institucioneve publike dhe palëve të interesuara, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore.

7. Rinovimi i licencës miratohet me vendim të Bordit të ERE-s, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve për vijimin e veprimtarisë së licencuar.

8. Në rast se kërkesa për rinovim nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ose refuzohet nga Bordi i ERE-s, licenca përfundon vlefshmërinë në datën e përcaktuar në të. Për vijimin e veprimtarisë pas kësaj date, subjekti duhet të paraqesë kërkesë të re për licencim, sipas procedurave të kësaj rregulloreje.

KREU III – PROCEDURAT E TJERA DHE DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33
Transferimi i licencës

1. Transferimi i plotë ose i pjesshëm i licencës bëhet vetëm me miratimin të ERE-s, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 59/2026 dhe dispozitat e kësaj rregulloreje. Kërkesa për transferim mund të paraqitet nga i licencuari ose nga palët e përfshira në marrëveshjen e transferimit.
2. Për transferimin e licencës, aplikuesi paraqet pranë ERE-s dokumentacionin e mëposhtëm:
   a) kërkesën për transferimin e plotë ose të pjesshëm të licencës, sipas formatit të përcaktuar nga ERE;
   b) informacionin mbi arsyet e transferimit dhe rrethanat që e kanë bërë të nevojshëm atë;

c) marrëveshjen e lidhur ndërmjet të licencuarit dhe subjektit përfitues, ku përcaktohen objekti i transferimit, të drejtat dhe detyrimet që kalojnë, data e parashikuar e realizimit të transferimit dhe përgjegjësitë e palëve;
d) informacionin mbi ndikimin e pritshëm të transferimit në vijimësinë e veprimtarisë së licencuar, sigurinë e furnizimit dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj klientëve dhe pjesëmarrësve të tregut, sipas rastit;
e) vendimet e organeve drejtuese të subjekteve të përfshira, nëpërmjet të cilave miratohet transferimi;
f) deklaratën e subjektit përfitues për marrjen përsipër të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar dhe përmbushjen e detyrimeve që lidhen me të;
g) dokumentacionin financiar, teknik, organizativ dhe profesional të subjektit përfitues, në përputhje me kërkesat e licencimit për veprimtarinë përkatëse;
h) dokumentacionin që vërteton burimet financiare dhe kapacitetin e subjektit përfitues për vijimin e veprimtarisë së licencuar;
i) miratimin ose qëndrimin e autoritetit tjetër kompetent, kur transferimi kushtëzohet nga një miratim i tillë sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rastet e transferimit të pjesshëm të licencës, dokumentacioni i paraqitur duhet të identifikojë qartë veprimtarinë, kapacitetet, asetet dhe të drejtat që transferohen, si dhe ato që mbeten në përgjegjësi të të licencuarit fillestar. ERE vlerëson nëse ndarja e veprimtarisë mundëson ushtrimin e pavarur dhe të sigurt të saj nga secili subjekt.

4. Kur transferimi i licencës shoqërohet me transferimin e aseteve që përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar, aplikimi për transferimin e licencës paraqitet paralelisht me kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve, sipas rregullores përkatëse të ERE-s dhe nenit 46 të ligjit nr. 59/2026.

5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ERE vlerëson nëse subjekti përfitues përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, kapacitetin e tij financiar, teknik dhe organizativ, si dhe mundësinë për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë dhe përmbushjen e detyrimeve që lidhen me licencën.

6. Transferimi i licencës nuk sjell përjashtimin e të licencuarit nga përgjegjësitë dhe detyrimet e lindura deri në datën e efektivitetit të transferimit, përveç rasteve kur legjislacioni në fuqi parashikon ndryshe. Subjekti përfitues merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që lidhen me licencën, sipas kushteve të miratuara nga ERE.

7. Transferimi i licencës nuk prodhon efekte juridike përpara miratimit paraprak nga ERE. Deri në datën e hyrjes në fuqi të vendimit për transferimin, i licencuari vijon të jetë përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licenca.

8. Pas përfundimit të shqyrtimit, Bordi i ERE-s vendos për miratimin ose refuzimin e transferimit të licencës. Vendimi përcakton subjektin përfitues, objektin e transferimit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë dhe datën nga e cila transferimi prodhon efekte.

Neni 34

Njohja e licencave të huaja

1. Njohja e licencave të lëshuara nga autoritetet rregullatore të huaja bëhet vetëm në rastet e parashikuara nga ligji nr. 59/2026, marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme, duke u bazar në parimin e reciprocitetit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Subjekti që kërkon njohjen e licencës paraqet pranë ERE-s kërkesën përkatëse, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
   a) kopjen e licencës së lëshuar nga autoriteti rregullator i huaj, ku përcaktohen veprimtaria për të cilën është dhënë, afati i vlefshmërisë dhe kushtet e ushtrimit të saj;
   b) dokumentin ose konfirmimin zyrtar të autoritetit lëshues që vërteton se licenca është e vlefshme, nuk është pezulluar, revokuar ose hequr dhe se subjekti gëzon të drejtën për të ushtruar veprimtarinë përkatëse;
   c) dokumentacionin që vërteton statusin juridik dhe regjistrimin e subjektit në shtetin ku është themeluar dhe dokumentacionin e hapjesë së degës/filialit në Republikën e Shqipërisë;
   d) informacionin mbi veprimtarinë që subjekti kërkon të ushtrojë në Republikën e Shqipërisë dhe mënyrën e organizimit të saj;
   e) informacionin mbi masat rregullatore ose administrative të marra ndaj subjektit autoriteti lëshues, nëse ka të tilla, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar;
   f) dokumentacionin tjetër që ERE e vlerëson të nevojshëm sipas rastit për procedurën.

3. ERE do t'i përgjigjet kërkesës për njohje licence me miratim ose jo brenda 30 (tridhjetë) ditëve

Neni 35

Procedura e thjeshtuar

1. Për operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë që kanë përfituar që përfitojnë nga dispozitat kalimtare të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026, ERE zbaton procedurë të thjeshtuar për pajisjen me licencë, në përputhje me afatin dhe kushtet e përcaktuara në këtë dispozitë ligjore.

2. Operatorët që përfitojnë nga regjimi kalimtar paraqesin pranë ERE-s kërkesën për licencim, të shoqëruar me formularin përkatës dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të licencimit.

3. Për shqyrtimin e kërkesës, ERE përdor dokumentacionin dhe informacionin e administruar gjatë procedurës së njoftimit dhe regjistrimit të impiantit të depozitimit. Dokuentet që ndodhen në dosjen e operatorit pranë ERE-s dhe që janë ende të vlefshme nuk kërkohet të paraqiten përsëri, përveç rasteve kur nevojitet përditësimi ose plotësimi i tyre.

4. Pas regjistrimit të kërkesës, struktura përgjegjëse për licencimin shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe atë të administruar më parë pranë ERE-s, për të verifikuar përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për licencimin. Në rast se konstatohen mangësi ose nevojitet informacion shtesë, ERE njofton operatorin për plotësimin e dokumentacionit, duke përcaktuar dokumentet që mungojnë dhe afatin për paraqitjen e tyre.

5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, struktura përgjegjëse përgatit relacionin dhe propozimin për fillimin e procedurës së licencimit, të cilat i paraqiten Bordit të ERE-s për vendimmarrje.

6. Pas vendimit të Bordit për fillimin e procedurës, ERE publikon njoftimin për aplikimin, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 59/2026 dhe procedurën e përcaktuar në këtë rregullore. Njoftimi përmban të dhënat kryesore të operatorit dhe të impiantit të depozitimit, si dhe afatin për paraqitjen e vërejtjeve dhe kundërshtimeve nga institucionet publike dhe palët e interesuara.

7. Struktura përgjegjëse shqyrton komentet, kundërshtimet dhe opioninet paraqitura, si dhe informacionin dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar gjatë procedurës, dhe përgatit relacionin përfundimtar për shqyrtim nga Bordi i ERE-s.

8. Bordi i ERE-s, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve ligjore, teknike, financiare dhe organizative, vendos për dhënien ose refuzimin e licencës për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë.

9. Procedura e thjeshtuar nuk përbën përjashtim nga detyrimi për përmbushjen e kushteve të licencimit dhe nuk cenon kompetencën e ERE-s për të verifikuar dokumentacionin, gjendjen teknike të impiantit dhe përmbushjen e kërkesave të sigurisë dhe operimit, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Operatorët që përfitojnë nga regjimi kalimtar vijojnë ushtrimin e veprimtarisë në kushtet dhe për periudhën e parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, deri në përfundimin e regjimit kalimtar dhe në përputhje me detyrimet ligjore përkatëse.

Neni 36

Regjistri publik i licencave

1. ERE mban regjistër elektronik të përditësuar, ku përfshihet emri dhe NUIS-i i subjektit, veprimtaria e licencuar, numri dhe seria e licencës, numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s, kohëzgjatja e licencës, kapacitetin dhe vendndodhja e burimit gjenerues (në rastin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike), statusi, përfshirë modifikimet, rinovimet, transferimet, njohjet, çdo ndryshim të vendimmarrjes, si dhe të dhëna të tjera, sipas rastit.

2. Publikimi respekton mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin tregtar dhe detyrimet e transparencës.

Neni 37

Pagesa e aplikimit

1. Pagesat për dhënie, modifikim, rinovim, njohje dhe transferim të licencës përcaktohen në aneksin 12, në përputhje me kompetencën ligjore të ERE-s.

2. Pagesat e reja ose të ndryshuara miratohen me vendim të posaçëm dhe nuk zbatohen vlera të trashëguara pa verifikuar bazën ligjore dhe proporcionalitetin e tyre.

Neni 38

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Aplikuesi identifikon në mënyrë të arsyetuar informacionin për të cilin kërkon trajtim konfidencial; ERE vendos sipas legjislacionit për të drejtën e informimit dhe sekretin tregtar.

2. Vendimet dhe të dhënat e detyrueshme për publikim nuk përjashtohen nga transparenca vetëm mbi bazën e kërkesës së aplikuesit.

Neni 39

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

1. Vendimet e ERE-s mund të kundërshtohen sipas mjeteve, kushteve dhe afateve të përcaktuara nga ligji nr. 59/2026 dhe legjislacioni procedural i zbatueshëm.

2. Çdo vendim përmban udhëzimin e saktë për organin kompetent dhe afatin e ankimit.

Neni 40

Dispozita kalimtare

1. Aplikimet e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje trajtohen sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 59/2026.

2. Licencat e dhëna më parë mbeten të vlefshme sipas kushteve të tyre dhe dispozitave ligjore kalimtare, pa cenuar detyrimin për përshtatje.

Neni 41

Dispozita përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin, Njohjen dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

2. Aplikimet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe njohjen e licencave, për të cilat procedura administrative ka filluar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shqyrtohen

dhe përfundojnë sipas dispozitave procedurale në fuqi në momentin e fillimit të procedurës, përveç rasteve kur zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje është më i favorshëm për aplikuesin dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

3. Licencat e dhëna nga ERE përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vijojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e afatit të tyre ose deri në ndryshimin, pezullimin apo heqjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Dokumentacioni dhe informacioni i administruar nga ERE në kuadër të procedurave të mëparshme të licencimit, modifikimit, transferimit, rinovimit dhe njohjes së licencave, përdoret edhe për zbatimin e kësaj rregulloreje, për aq sa është i vlefshëm dhe nuk ka pësuar ndryshime.

5. Çështjet që nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë rregullore trajtohen në përputhje me ligjin nr. 59/2026, Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Bordit të ERE-s dhe hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për botimin dhe hyrjen në fuqi të akteve normative.

ANEKSET

e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe njohjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike

Shënim: Anekset përcaktojnë formatin e informacionit dhe dokumentacionit që paraqitet nga aplikuesi. Dokumentet kërkohen vetëm kur lidhen me veprimtarinë konkrete, janë të zbatueshme dhe nuk disponohen tashmë nga ERE në formë të vlefshme. Anekset nuk krijojnë veprimtari të reja të licencueshme, përjashtime ose tarifa që nuk parashikohen nga ligji dhe aktet e ERE-s.

PËRMBAJTJA

Aneksi 1 – Formulari i përgjithshëm i aplikimit dhe deklaratat

Aneksi 2 – Dokumentacioni juridik, financiar dhe i kapacitetit organizativ e profesional

Aneksi 3 – Dokumentacioni për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Aneksi 4 – Dokumentacioni për veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes dhe sistemeve të mbyllura të shpërndarjes

Aneksi 5 – Dokumentacioni për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

Aneksi 6 – Dokumentacioni për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike

Aneksi 7 – Dokumentacioni për veprimtarinë e operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike të lidhura në rrjetin e transmetimit

Aneksi 8 – Dokumentacioni për veprimtarinë e agregimit të energjisë elektrike

Aneksi 9 – Dokumentacioni për modifikimin, rinovimin, transferimin dhe njohjen e licencës

Aneksi 10 – Dokumentacioni për pikat e rikarikimit të automjeteve elektrike të aksesueshme nga publiku dhe dokumentacioni për procedurën e posaçme të OSSH-së

Aneksi 11 – Informacion plotësues për klientët aktivë dhe komunitetet energjetike

Aneksi 12 – Tarifat e aplikimit

Aneksi 13 – Modeli i regjistrit publik të licencave

ANEKSI 1 – FORMULARI I PËRGJITHSHËM I APLIKIMIT DHE DEKLARATAT

Plotësohet për çdo kërkesë për dhënie licence. Për modifikimin, rinovimin, transferimin dhe njohjen plotësohet edhe formulari përkatës i Aneksit 9.

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Emri i plotë i aplikuesit / emërtimi tregtar	
Forma juridike dhe numri unik i identifikimit (NUIS/NIPT), kur aplikohet	
Adresa e selisë dhe të dhënat e kontaktit	
Emri, funksioni, telefoni dhe adresa elektronike e personit të kontaktit	
Emri i përfaqësuesit ligjor dhe dokumenti që provon të drejtën e përfaqësimit	
Veprimtaria për të cilën kërkohet licenca	
Afati i kërkuar i licencës, kur duhet të përcaktohet nga aplikuesi	
Vendndodhja e impiantit, objektit ose zona e ushtrimit të veprimtarisë, sipas rastit	
Kapaciteti i instaluar (MW), kapaciteti energjetik (MWh) dhe të dhëna të tjera teknike, sipas rastit	
Faza e projektit ose statusi aktual i veprimtarisë (projektim, ndërtim, testim, në operim)	
Data e parashikuar e fillimit të veprimtarisë, sipas rastit	
Numri dhe data e dokumentit të pagesës së aplikimit	
Lista e dokumenteve dhe anekseve të paraqitura	

DEKLARATA E APLIKUESIT

Aplikuesi deklaron se informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur janë të sakta dhe të plota; se dokumentet janë autentike dhe të vlefshme; se ka bërë të ditur çdo rrethanë që mund të ndikojë në shqyrtimin e kërkesës; se do të njoftojë ERE-n për ndryshimet e të dhënave të paraqitura gjatë shqyrtimit; dhe se, në rast dhënieje licence, do të respektojë legjislacionin në fuqi dhe kushtet e licencës.

Emri dhe funksioni i nënshkruesit: _____

Data: _____ Nënshkrimi/vula: _____

ANEKSI 2 – DOKUMENTACIONI JURIDIK, FINANCIAR DHE I KAPACITETIT ORGANIZATIV E PROFESIONAL

Dokumentacioni paraqitet sipas formës juridike të aplikuesit dhe natyrës së veprimtarisë. ERE nuk kërkon riparaqitjen e dokumenteve që i disponon dhe që janë ende të vlefshme, të plota dhe të mjaftueshme për shqyrtimin e kërkesës

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Ekstrakti i regjistrimit në regjistrin përkatës dhe dokumentet e themelimit, sipas rastit (Statuti ose akti i themelimit dhe ndryshimet e tij)	
Vendimi i organit kompetent të aplikuesit për paraqitjen e kërkesës për licencë	
Dokumenti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor dhe akti i përfaqësimit/autorizimit, kur aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi	
Struktura organizative dhe organigrama e aplikuesit	
Lista e personelit drejtues dhe stafit teknik, me funksionet përkatëse	
Dëshmi penaliteti (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për shoqërinë aplikuese dhe administratorin/administratorët	
Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca	
Plani i biznesit dhe parashikimet financiare, kur kërkohet për veprimtarinë	
Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore	
Procedura/rregullore të brendshme të shoqërisë për kontrollin dhe menaxhimin e riskut	
Procedura/rregullore të brendshme rë shoqërisë për sigurinë, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit tregtar	
Dokumentet e lëshuara nga autoritete të huaja, të përkthyera dhe të legalizuara/apostiluara, kur kërkohet nga legjislacioni	

ANEKSI 3 – DOKUMENTACIONI PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Dokumentacioni teknik përshtatet me burimin e energjisë, teknologjinë, kapacitetin dhe fazën e projektit.

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / Referenca**
Emri i impiantit dhe subjekti aplikues	
Vendndodhja administrative dhe koordinatat gjeografike	
Burimi i energjisë dhe teknologjia e prodhimit	
Fuqia e instaluar (MW), numri dhe karakteristikat kryesore të njësive gjeneruese	
Prodhimi vjetor i parashikuar (MWh), kur është i zbatueshëm	
Miratimi i pikes së lidhjes dhe/ose marrëveshja përkatëse me operatorin e rrjetit	
Akti i miratimit/autorizimit të ndërtimit të kapacitetit, kur kërkohet nga ligji	
Dokumentet e pronësisë ose e drejta e përdorimit të tokës dhe/ose objekteve, sipas aktit përkatës (miratimi i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, akti i privatizimit apo dokumentacioni përkatës që provon kalimin e së drejtës së pronësisë etj.)	
Lejet mjedisore, ujore dhe lejet e tjera, vetëm kur kërkohen nga legjislacioni	
Informacioni/dokumentacioni i ndërtimit, sipas fazës së projektit (raportimet/informimet tek institucionet/organet përgjegjëse)	
Grafiku i realizimit dhe informacioni mbi ecurinë e investimit, kur impianti është në ndërtim	
Dokumentacioni i testimit, kolaudimit dhe vënies në punë, kur impianti ka përfunduar	
Dokumentacioni që provon gjendjen teknike dhe gatishmërinë për operim, kur impianti është i ndërtuar	
Procedura/rregullore të brendshme të shoqërisë për mirëmbajtjen e impiantit, sigurinë teknike, mbrojtjen nga zjarri dhe procedurat e emergjencës	
Të dhënat për impiantin e depozitimit të integruar, kur ka: fuqi (MW), kapacitet (MWh), skemë lidhjeje dhe mënyrë operimi	

Për impiantet që janë tashmë të ndërtuar, nuk kërkohet dokumentacioni i plotë i projektimit, ndërtimit dhe investimit, kur këto dokumente nuk janë të nevojshme për verifikimin e kushteve të licencimit. Aplikuesi paraqet dokumentacionin që provon gjendjen aktuale, sigurinë teknike, lidhjen me rrjetin dhe gatishmërinë për vijimin e operimit. Kjo nuk përjashton paraqitjen e një dokumenti të caktuar kur ai kërkohet shprehimisht nga ligji.

ANEKSI 4 – DOKUMENTACIONI PËR VEPRIMTARITË E OPERIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE SISTEMEVE TË MBYLLURA TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Dokumentacioni paraqitet sipas veprimtarisë dhe shtrirjes së rrjetit për të cilin kërkohet licenca

A. TRANSMETIMI DHE SHPËRNDARJA

Nr.	**Plotësimi / Referenca**
Identifikimi i aplikuesit dhe veprimtaria për të cilën kërkohet licenca	
Zona e ushtrimit të veprimtarisë dhe kufijtë gjeografikë të rrjetit	
Përshkrimi i rrjetit dhe skemat kryesore elektrike	
Lista e aseteve kryesore, kapacitetet dhe nivelet e tensionit	
Dokumentet që provojnë pronësinë ose të drejtën e ligjshme të administrimit dhe përdorimit të aseteve	
Pikat e interkoneksionit dhe kapacitetet përkatëse	
Plani i zhvillimit dhe investimeve të rrjetit, kur kërkohet	
Programi i mirëmbajtjes dhe administrimit të aseteve	
Plani për reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, sipas veprimtarisë	
Treguesit e cilësisë dhe vazhdimësisë së furnizimit, kur janë të zbatueshëm	
Sistemet e matjes, telekomunikacionit, kontrollit dhe administrimit të rrjetit (përfshirë SCADA, kur aplikohet)	
Masat e sigurisë fizike dhe kibernetike	
Organizimi i personelit teknik dhe procedurat e emergjencës	

B. SISTEMET E MBYLLURA TË SHPËRNDARJES

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Identifikimi i operatorit dhe vendndodhja e sistemit	
Planimetria dhe kufijtë e sistemit të mbyllur	
Lista e përdoruesve dhe karakteristikat e konsumit/prodhimit brenda sistemit	
Skema elektrike, asetet dhe nivelet e tensionit	
Dokumentacioni që provon kushtet ligjore për klasifikimin si sistem i mbyllur	
Dokumentet e pronësisë ose të drejtës së administrimit dhe përdorimit të rrjetit	
Mënyra e matjes, operimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të aksesit	
Masat për trajtimin jodiskriminues të përdoruesve dhe respektimin e të drejtave të tyre	

ANEKSI 5 – DOKUMENTACIONI PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Dokumentacioni i kërkuar përshtatet me veprimtarinë dhe modelin e biznesit të aplikuesit

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Modeli i furnizimit dhe kategoritë e klientëve që synohet të furnizohen	
Parashikimi i numrit të klientëve dhe i portofolit të energjisë (MWh)	
Burimet e sigurimit të energjisë dhe marrëveshjet përkatëse, sipas rastit	
Strategjia për sigurimin e energjisë dhe administrimin e riskut të çmimeve te furnizimit	
Plan Biznesi, i cili të përmbajë parashikim të kostove, të të ardhurave dhe modalitetin e financimit	
Rregullore për trajtimin e ankesave dhe informimin e klientëve	
Informacion mbi sistemet IT dhe procedurat për sigurinë e të dhënave të klientëve	
Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit, kur këto të fundit kërkohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentacionin që vërteton burimet e financimit, planin e biznesit, ose dokumente të tjera që provojnë aftësinë dhe kapacitetin financiar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet licenca. Dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me natyrën, përmasat dhe kërkesat financiare të veprimtarisë përkatëse (*mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi dhe përllogaritjes që do të bëhet duke marrë për bazë çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit)*	

ANEKSI 6 – DOKUMENTACIONI PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Dokumentacioni duhet të provojë aftësinë e aplikuesit për të administruar tregun në mënyrë të sigurt, transparente dhe jodiskriminuese

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Përshkrimi i modelit të operimit të tregut dhe funksioneve që do të kryhen	
Rregullat dhe procedurat e administrimit të tregut	
Sistemet informatike, arkitektura teknike dhe kapacitetet e përpunimit	
Masat e sigurisë kibernetike, menaxhimi i incidenteve dhe vazhdimësia e shërbimit	
Mekanizmat e regjistrimit, pranimit dhe monitorimit të pjesëmarrësve	
Procedurat e ofertimit, përputhjes së ofertave dhe publikimit të rezultateve	
Procedurat e llogaritjes, shlyerjes dhe faturimit	
Marrëveshjet dhe protokollet e komunikimit me operatorët e sistemit dhe palët përkatëse	
Mekanizmat e mbikëqyrjes së tregut dhe identifikimit të sjelljeve të parregullta	
Procedurat për administrimin e konfliktit të interesit dhe ndarjen e funksioneve	
Garancitë dhe procedurat për trajtimin jodiskriminues të pjesëmarrësve	
Plani i vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit nga ndërprerjet	

ANEKSI 7 – DOKUMENTACIONI PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË LIDHURA NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

Dokumentacioni përshtatet me teknologjinë, konfigurimin (i pavarur ose i integruar) dhe fazën e projektit.

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Emri i impiantit dhe subjekti aplikues	
Vendndodhja dhe koordinatat gjeografike	
Teknologjia e depozitimit	
Fuqia nominale e karikimit (MW)	
Fuqia nominale e shkarkimit (MW)	
Kapaciteti energjetik i përdorshëm (MWh)	
Kohëzgjatja nominale e shkarkimit në fuqinë përkatëse	
Miratimi i pikës së lidhjes dhe/ose marrëveshja me operatorin e rrjetit	
Akti i miratimit të ndërtimit të kapacitetit të depozitimit të energjisë elektrike, i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose nga Këshilli i Ministrave, sipas kompetencës	
Strategjia dhe mënyra e operimit, përfshirë nëse impianti është i pavarur apo i integruar	
Procedura/rregullore të brendshme për sigurinë teknike, mbrojtjen nga zjarri dhe planet e emergjencës	
Dokumentacioni mjedisor	
Dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të impiantit, sipas aktit përkatës, (miratimi i lëshuar nga ministri përgjegjës për energjinë ose Këshilli i Ministrave, akti i privatizimit apo dokumentacioni përkatës që provon kalimin e së drejtës së pronësisë etj.)	
Dokumentacioni i testimit, kolaudimit dhe gatishmërisë për operim, sipas fazës	

Për impiantet e depozitimit që janë tashmë në operim, dokumentacioni përshtatet me gjendjen faktike. Nuk kërkohet riparaqitja e dokumentacionit të plotë të projektimit, ndërtimit dhe investimit, përveçse kur një dokument i caktuar është i nevojshëm për verifikimin e një kushti ligjor ose teknik.

ANEKSI 8 – DOKUMENTACIONI PËR VEPRIMTARINË E AGREGIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Dokumentacioni duhet të provojë kapacitetet financiare, organizative dhe profesionale, si dhe aftësinë për të përmbushur përgjegjësitë e agreguesit

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Modeli i agregimit dhe shërbimet që do të ofrohen	
Kategoritë e burimeve, prodhuesve, klientëve ose konsumatorëve që do të agregohen	
Parashikimi i portofolit dhe kapaciteteve të agreguara	
Kontratat standarde dhe kushtet e pjesëmarrjes së klientëve	
Procedurat e informimit, transparencës dhe marrjes së pëlqimit të klientëve	
Sistemet e komunikimit, matjes dhe shkëmbimit të të dhënave	
Procedurat e administrimit, ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave	
Masat për mbrojtjen e informacionit tregtar dhe konfidencial	
Procedurat për menaxhimin e riskut operacional dhe tregtar	
Mënyra e përmbushjes së përgjegjësive të balancimit ose marrëveshja përkatëse	
Masat për shmangien e diskriminimit dhe garantimin e trajtimit të barabartë	
Procedurat e trajtimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	
Procedurat e raportimit dhe komunikimit me ERE-n dhe operatorët e sistemit	

ANEKSI 9 – FORMULARËT PËR MODIFIKIMIN, RINOVIMIN, TRANSFERIMIN DHE NJOHJEN E LICENCËS

Aplikuesi plotëson formularin dhe paraqet dokumentet që provojnë ndryshimin ose rrethanën për të cilën kërkohet vendimmarrja; dokumentet e pandryshuara që ERE i disponon nuk riparaqiten, kur janë të vlefshme.

A. FORMULARI I MODIFIKIMIT TË LICENCËS

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Numri dhe data e licencës	
Elementi i licencës që kërkohet të modifikohet	
Përshkrimi i gjendjes aktuale	
Përshkrimi i ndryshimit të propozuar	
Arsyetimi dhe baza ligjore e kërkesës	
Ndikimi në kapacitet, vendndodhje, teknologji, asete ose kushte operimi	
Dokumentet provuese	
Lejet, miratimet, autorizimet apo aktet e tjera përkatëse, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi për realizimin e ndryshimit të propozuar, sipas natyrës së modifikimit dhe veprimtarisë së licencuar	
Data e propozuar për zbatimin e ndryshimit	

B. FORMULARI I RINOVIMIT TË LICENCËS

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Numri dhe data e licencës dhe data e përfundimit të vlefshmërisë	
Afati për të cilin kërkohet rinovimi, kur aplikohet	
Përshkrimi i vijimësisë së veprimtarisë	
Ndryshimet teknike, juridike, financiare dhe organizative gjatë periudhës së licencës, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, sipas rastit	
Informacioni mbi përmbushjen e detyrimeve rregullatore	
Detyrimet e papërmbushura dhe masat e marra për përmbushjen e tyre	
Gjendja teknike dhe financiare e veprimtarisë	
Dokumentacioni i përditësuar që mbështet kërkesën (lejet, autorizimet, miratimet dhe aktet e tjera të nevojshme për vijimin e ushtrimit e veprimtarisë)	

C. FORMULARI I TRANSFERIMIT TË LICENCËS

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Subjekti i licencuar dhe të dhënat e licencës	
Subjekti përfitues dhe të dhënat identifikuese	
Natyra e transferimit (i plotë ose i pjesshëm), sipas rastit	
Objekti dhe arsyet e transferimit	
Të drejtat dhe detyrimet që kërkohet të kalojnë	
Asetet që lidhen me veprimtarinë e licencuar	
Marrëveshja e transferimit dhe data e synuar e realizimit	
Dokumentacioni për kapacitetet juridike, financiare, teknike dhe organizative të përfituesit	
Miratimet ose autorizimet e tjera të kërkuara nga legjislacioni	
Masat për vijimësinë e veprimtarisë dhe mbrojtjen e klientëve/përdoruesve, kur zbatohen	

Ç. FORMULARI I NJOHJES SË LICENCËS SË HUAJ

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Emri i subjektit dhe shteti i themelimit	
Autoriteti rregullator që ka lëshuar licencën	
Numri, data e lëshimit dhe afati i vlefshmërisë së licencës	
Veprimtaria dhe territori për të cilin është lëshuar licenca	
Statusi aktual i licencës dhe kufizimet, nëse ka	
Dokumentacioni që vërteton statusin juridik dhe regjistrimin e subjektit në shtetin ku është themeluar dhe dokumentacionin e hapjes së degës/filialit në Republikën e Shqipërisë (ekstrkat atedur nga QKB)	
Dokumenti I autoritetit lëshues që konfirmon vlefshmërinë, kur kërkohet	
Masat administrative ose rregullatore ndaj subjektit, kur janë relevante	
Veprimtaria dhe shtrirja për të cilën kërkohet njohja në Republikën e Shqipërisë	
Përkthimi dhe legalizimi/apostilimi I dokumentacionit, sipas legjislacionit	

ANEKSI 10 – DOKUMENTACIONI PËR OPERIMIN E PIKAVE TË RIKARIKIMIT TË AUTOMJETEVE ELEKTRIKE TË AKSESUESHME NGA PUBLIKU DHE DOKUMENTACIONI PËR PROCEDURËN E POSAÇME TË OSSH-SË

Ky aneks nuk krijon vetvetiu detyrim licencimi për operatorët e pikave të rikarikimit. Ai përdoret vetëm në rastet kur një dispozitë ligjore ose akt I ERE-s, I nxjerrë në bazë të një atedures të shprehur ligjore, kërkon paraqitjen e dokumentacionit përkatës. Pjesa B lidhet veçmas me procedurën e posaçme të OSSH-së.

A. INFORMACIONI TEKNIK PËR PIKAT E RIKARIKIMIT

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Identifikimi I operatorit dhe të dhënat e tij juridike	
Vendndodhja dhe koordinatat e ate/pikave të rikarikimit	
Numri i pajisjeve dhe karakteristikat (publike ose private)	
Prodhuesi, modeli dhe standardet teknike të pajisjeve	
Fuqia nominale për pajisje dhe fuqia totale e instaluar (kW/MW)	
Lloji i rrymës dhe standardi i lidhësve (AC/DC), sipas pajisjes	
Skema elektrike, pajisjet mbrojtëse, tokëzimi dhe masat e sigurisë	
Pika dhe niveli i tensionit të lidhjes, si dhe kapaciteti I miratuar	
Miratimi i lidhjes dhe marrëveshja me operatorin e rrjetit	
Sistemi i matjes, komunikimit dhe administrimit të të dhënave	
Mënyra e furnizimit me energji dhe marrëdhënia me furnizuesin	
Mënyra e informimit të përdoruesve, faturimit dhe pagesës, kur aplikohet	
Procedurat e mirëmbajtjes, monitorimit dhe trajtimit të defekteve/emergjencave	
Dokumentacioni i testimit dhe verifikimit të sigurisë/gatishmërisë teknike	

B. DOKUMENTACIONI PËR PROCEDURËN E POSAÇME TË OSSH-SË

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Relacioni që argumenton nevojën për përfshirjen e OSSH-së në ofrimin e shërbimit përkatës	
Dokumentacioni që provon plotësimin e kushteve ligjore për ndërhyrjen e OSSH-së, përfshirë vlerësimin e atedur të palëve të treta, sipas rastit	
Analiza teknike dhe ekonomike e alternativave	
Dokumentacioni ipërzgjedhjes/tenderimit, kur kërkohet	

Draft-marrëveshja ose kontrata dhe ndarja e përgjegjësive	
Masat për aksesin e palëve të treta dhe trajtimin jodiskriminues	
Masat për ndarjen e kostove dhe shmangien e subvencionimit të kryqëzuar, kur kërkohet	
Miratimet dhe autorizimet e tjera të kërkuara nga ligji dhe aktet zbatuese	

Dokumentacioni i kësaj pjese administrohet vetëm për procedurën përkatëse të OSSH-së dhe nuk duhet të interpretohet si aplikim i zakonshëm për licencim ioperatorit të pikave të rikarikimit.

ANEKSI 11 – INFORMACION PLOTËSUES PËR KLIENTËT AKTIVË DHE KOMUNITETET ENERGJETIKE

Ky aneks nuk krijon licencim të statusit të klientit aktiv ose të komunitetit energjetik. Ai plotësohet vetëm kur subjekti kërkon licencë për një veprimtari konkrete që, sipas ligjit, I nënshtrohet licencimit dhe nuk përjashtohet shprehimisht.

A. INFORMACION PLOTËSUES PËR KLIENTIN AKTIV

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Të dhënat identifikuese të klientit dhe dokumentacioni që provon statusin përkatës, kur është I nevojshëm	
Veprimtaria konkrete për të cilën kërkohet licenca	
Impiantet e prodhimit ose depozitimit dhe e drejta e aplikuesit mbi to	
Fuqia e instaluar (MW) dhe kapaciteti energjetik (MWh), sipas rastit	
Dokumentacioni I lidhjes me rrjetin dhe identifikimi I pikave të matjes	
Mënyra e matjes së energjisë së konsumuar, prodhuar, injektuar ose depozituar	
Mënyra e përmbushjes së përgjegjësisë së balancimit, kur zbatohet	
Marrëveshjet për shitjen, agregimin ose ofrimin e fleksibilitetit, sipas rastit	
Dispozita ligjore mbi të cilën mbështetet përjashtimi nga licencimi, nëse pretendohet	

B. INFORMACION PLOTËSUES PËR KOMUNITETIN ENERGJETIK

Të dhënat / dokumenti	**Plotësimi / referenca**
Emri dhe forma juridike e komunitetit	
Dokumenti I regjistrimit, kur kërkohet dhe sipas rregullores së posaçme të regjistrimit	
Statuti dhe akti I themelimit	
Lista e anëtarëve dhe dokumentacioni që provon përbërjen, sipas rastit	
Struktura drejtuese dhe organet vendimmarrëse	
Rregullat e pranimit, largimit dhe pjesëmarrjes së anëtarëve	
Veprimtaria konkrete për të cilën kërkohet licenca, nëse kërkohet	
Impiantet, fuqia (MW), kapaciteti (MWh), vendndodhja dhe lidhja me rrjetin	
Mënyra e matjes dhe administrimit të energjisë së prodhuar, konsumuar ose ndarë	
Mënyra e përmbushjes ose delegimit të përgjegjësisë së balancimit, sipas rastit	
Mënyra e administrimit dhe shpërndarjes së përfitimeve	
Ndryshimet nga dokumentacioni I regjistrimit që disponon ERE	

Për komunitetet e energjisë së rinovueshme që regjistrohen pranë ERE-s sipas rregullores së posaçme, dokumentacioni I regjistrimit që ERE e disponon nuk riparaqitet, përveç rasteve kur kërkohet përditësim ose kur ka ndryshime që ndikojnë në shqyrtimin e kërkesës.

ANEKSI 12 – TARIFAT E APLIKIMIT

Veprimtaria	**Licencim**	**Modifikim**	**Rinovim**	**Transferim**	**Njohje licence**	**Kopje e njësuar e licencës**
Prodhimi ienergjisë elektrike	500 000 lekë + 250 000 lekë për çdo central shtesë	250 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	—	15 000 lekë
Operimi i sistemit të transmetimit	1 000 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	—	15 000 lekë
Operimi i sistemit të shpërndarjes	1 000 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	—	15 000 lekë
Furnizimi i energjisë elektrike	500 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	15 000 lekë
Tregtimi i energjisë elektrike	400 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	15 000 lekë
Operimi i tregut të energjisë elektrike	1 000 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	500 000 lekë	—	15 000 lekë
Sistemet e mbyllura të shpërndarjes	500 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	—	15 000 lekë
Depozitimi i energjisë elektrike	500 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	250 000 lekë	—	15 000 lekë
Agregimi	400 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	—	15 000 lekë
Operimi i pikave të rikarikimit	400 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	200 000 lekë	—	15 000 lekë

Shënime:

1. Për prodhimin, pagesa e licencimit përbëhet nga tarifa fikse prej 500 000 lekësh për centralin e parë dhe 250 000 lekë për çdo central shtesë.

2 Pagesa kryhet në momentin e paraqitjes së aplikimit dhe është e pakthyeshme, sipas Aneksit A në fuqi. Të dhënat bankare dhe mënyra e pagesës duhet të jenë ato të përcaktuara në aktin tarifor aktual të ERE-s.

ANEKSI 13 – MODELI I REGJISTRIT PUBLIK TË LICENCAVE

Modeli përcakton të dhënat bazë që pasqyrohen në regjistrin publik, në masën që publikimi i tyre lejohet nga legjislacioni në fuqi.

Fusha e regjistrit	**Të dhënat që pasqyrohen**
Numri dhe seria e licencës	Numri unik dhe seria e licencës
Subjekti i licencuar	Emri i plotë dhe NUIS/NIPT
Veprimtaria	Veprimtaria/veprimtaritë e licencuara
Të dhëna identifikuese të licencës	Numri dhe seria
Vendimmarrja e Bordit	Numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s
Vendndodhja ose territori	Vendndodhja e burimit gjenerues, e ushtrimit të veprimtarisë, ose të dhëna të tjera sipas rastit
Kapaciteti	Fuqia (MW), kapaciteti energjetik (MWh) ose të dhëna të tjera të licencës, sipas rastit
Vendimi i Bordit	Numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s
Kohëzgjatja e licencës	Data e fillimit dhe data e përfundimit të vlefshmërisë
Statusi	Aktive ose status tjetër i pasqyruar në përputhje me vendimin përkatës
Ndryshimet e licencës	Vendimet për modifikim, rinovim, transferim, njohje, si dhe cdo ndryshim të vendimmarrjes
Shënime	Të dhëna të tjera që publikohen sipas ligjit

Në regjistrin publik nuk përfshihen të dhëna personale, sekrete tregtare ose informacione të tjera të mbrojtura, përveç rasteve kur publikimi kërkohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.